



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezuar Prilbjen / Prifato Received / Delivery	27 - 11 2023	3 viti god year	
Organi / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHAK	7123 / 2023		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1281/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1281/2023 të datës 13.10.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër të protokollit Nr.prot.02-030/01-11967/23 të datës 05.10.2023 të Komisionit për pranim të kandidatëve në Komunën e Leposaviqit, në çështjen juridike „Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1281/2023 e datës 13.10.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Njoftimi i datës 05.10.2023 për rezultatin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit për procedurën e rekrutimit „Udhëheqës i Sektorit për Gjeodezi dhe Kadastër”, i shpallur nga Komuna e Shtërpcës.
- III. Anulohet procedura e rekrutimit për pozitën „Udhëheqës i Sektorit për Gjeodezi dhe Kadastër”, e shpallur nga Komuna e Shtërpcës me datën 15.08.2023 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- IV. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Shtërpcës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Shtërpcës në bazë të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë (në tekstin në vijim-Ligji i aplikuar) nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 39 paragrafët (1,2 dhe 3) dhe nenin 52 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht më datë 15.08.2023 ka njoftuar lidhur me konkursin për ngritje (avancim) në detyrë me numër reference RN00012324, për pozitën „Udhëheqës i Sektorit për Kadastër dhe Gjeodezi“ në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, ku afati për aplikim ka qenë nga data 30.08.2023 deri më 06.09.2023.

Në bazë të njoftimit me Nr.prot.02-030-01-10642/23 të datës 08.09.2023, të Udhëheqëses së Njesisë së Personelit në Komunën e Shtërpcës, për procedurën e verifikimit paraprak ankuesi është përfshirë në listën e shkurtë dhe ka fituar të drejtën e konkurrimit në këtë procedurë. Ndërsa më datë 27.09.2023 pas zhvillimit të procedurës së testimit me shkrim, intervistës me gojë dhe vlerësimit të CV-së, Udhëheqësja e Njesisë së Personelit ka nxjerrë Njoftimin me Nr.prot. 02-030/01-11606/23 për renditjen përfundimtare përmes së cilit ankuesi është njoftuar se nga ky proces i vlerësimit ka marrë gjashtëdhjetë (60) pikë duke u renditur i dyti në listë.

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin Nr.prot. 02-030/01-11606/23 të datës 27.09.2023, të Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Shtërpcës, më datë 03.10.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokoll Nr.prot 02-150/02-11867/23 pranë Komisionit të Ankesave në Komunën e Shtërpcës. Ndërsa më datë 05.10.2023 Komisioni për pranimin e kandidatëve ka nxjerrë Vendim me numër protokoll Nr.prot.02-030/01-11967/23 përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e datës 03.10.2023 të parashtruar nga ankuesi.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.prot.02-030/01-11967/23 të datës 05.10.2023 të Komisionit për pranimin e kandidatëve në Komunën e Shtërpcës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.10.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6531/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, me datën 16.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Shtërpcës. Ndërsa Këshilli më datë 18.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoll Nr.prot.02-030/01-12488/23 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6531/2023 të datës 13.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit me numër 102584; Vendimin me numër protokoll Nr.prot.02-030/01-11967/23 të datës 05.10.2023; Ankesën me numër protokoll Nr.prot.02-150/02-11867/23 të datës 03.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin e Ankesave të Komunës së Shtërpcës; Njoftimin me numër protokoll Nr.prot.02-030/01-11606/23 të datës 27.09.2023; Konkursin me numër reference RN00012324 të datës 30.08.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.10.2023; Përgjigjen në

ankesë me numër protokoll 1281/2023 të datës 23.10.2023; Listën e kandidatëve të aprovuar me numër reference RN00012324; Lajmërimin me numër protokoll Nr.prot.02-030-01-10642/23 të datës 08.09.2023; Vendimin me numër protokoll Nr.prot.02-030/01-10851/23 të datës 11.09.2023; Renditjen përfundimtare të kandidatëve me numër të procedurës RPC0005641 të datës 05.10.2023; Diplomën me numër Nr.OA-000367 të datës 23.05.2014; Certifikatën e datës 24.02.2012 të lëshuar nga USAID; Certifikatën e kursit të gjuhës shqipe të datës 12.12.2013; Kontratë e punës me numër 03 Nr.48/2009 e datës 04.03.2009; Certifikatë mbi dënimet penale me numër Nr.ser. F9464C6A1517447 e datës 06.10.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 03.01.2023; Akt Emërimin me numër Nr.02-16-4423 i datës 27.12.2012; Diplomën me numër Nr.427/14 të lëshuar nga BPRAL-PPHE Kolegji Universum/Dega Ferizaj; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 27.12.2022; Certifikatën Prill 2012 të lëshuar nga Consultancy Training Development, Certifikatën e kursit të gjuhës serbe të datës 12.12.2013 të lëshuar nga European Centre for Minority Issues Kosovo, OSCE, Zyra e Kryeministrit të Kosovës; Certifikatën e datës 5-6 Nëntor të datës 2009 të lëshuar nga OSCE; Certifikatën e datës 05.10.2012 të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe nga Qendra Kosovare për Zhvillim; Certifikatën shkurt,2014 të lëshuar nga ARDP dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Certifikatën e lëshuar nga Regional Marketing Centre-EAST; Certifikatën dhjetor 2014 të lëshuar nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës; Certifikatën e datave 16-17, 23-24, 30-31 maj 2012 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike; Akt Emërimin me numër protokoll nr.prot.02-16-4418 të datës 27.12.2012; E-mailin e datës 27.10.2023 nga drejtuar E-mailat e datës 17.11.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se sipas Konkursit me Nr. Reference: RN00012324 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën „Udhëheqës i Sektorit për Kadastër dhe Gjeodezi” si kriteret të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Diplomimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë në së paku 3 vite të studimeve;*
- *Kualifikime të Posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar dy (2) kandidatë, sipas njoftimit me numër protokoll Nr.prot.02-030-01-10642/2023 të datës 08.09.2023 të dy (2) kandidatët i kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe të njëjtit janë përfshirë në listën e ngushtë. Komisioni për pranim i themeluar sipas Vendimit me numër protokoll nr.prot.02-030/01-10851/23 të datës 11.09.2023 pas përfundimit të intervistës, më datë 27.09.2023 ka përgatitur listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, sipas të cilës kandidati është radhitur i pari në listë me gjithsejtë tetëdhjetë e dy (82) pikë, ndërsa ankuesi është radhitur i dyti në listë me gjithsejtë gjashtëdhjetë (60) pikë .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me mandatin kushtetues për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë kryerjes së funksioneve dhe përgjegjësisive, gjegjësisht funksionit të shqyrtimit të ankesave ka shqyrtuar procedurën e rekrutimit për pozitën e punës „ Udhëheqës për Kadastër dhe Gjeodezi”, si dhe pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi

sepse kandidati i përzgjedhur nuk e ka të nostrifikuar Diplomën e studimeve Universitare, ndërlidhur me këtë Kolegji i Këshillit ka analizuar dosjen e kandidatit fitues, dhe pas vlerësimit ka konstatuar se kandidati si dëshmi të kualifikimit shkollorë ka ofruar: *Diplomën me numër OA-01-337/14 të lëshuar më datë 23.05.2014 nga Universiteti Shtetëror i Novi Pazarit me të cilën dëshmohet se më datë 17.12.2013 ka përfunduar Fakultetin Juridik në programin e studimeve Juridike, dhe ka marrë titullin „Jurist i diplomuar“* Republika e Serbisë, mirëpo nga organi i punësimit si palë në këtë procedurë nuk na është ofruar asnjë dëshmi që e njëjta Diplomë është nostrifikuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, nga se nostrifikimi i diplomës në këso situata është obligative sipas legjislacionit që rregullon këtë aspektë që ndërlidhet me këtë rastë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qenë se ka vërejtur se mungon dëshmia lidhur me nostrifikimin e Diplomës së kandidatit i cili sipas Vendimit me Nr.prot.02-030/01-10851/23 të datës 11.09.2023 të Komisionit të pranimit në Komunën e Shtërpcës ishte përzgjedhur si kandidati fitues për pozitën e punës „Udhëheqës i Sektorit për Kadastër dhe Gjeodezi“, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit më datë 26.10.2023 përmes e-mailit zyrtarë ka kërkuar nga Menaxherja e Personelit në Komunën e Shtërpcës prova shtesë, konkretisht dëshminë për nostrifikimin e Diplomës së kandidatit fitues. ndërsa më datë 27.10.2023 Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Shtërpcës, përmes e-mailit zyrtar është përgjigjur në kërkesën e datës 26.10.2023 ku ka theksuar se: *“Në vazhdim po ju dërgoj një komunikim me ministrinë e Arsimit e cila na ka dhënë një përgjigje në lidhje me nostrifikimin e diplomave. Me duhet të theksoj se kandidati nuk është në gjendje të nostrifikoj diplomën e tij për arsyt e lartpërmendura, është punonjës që është i punësuar tek ne që nga viti 2009, i cili ka fituar njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në këtë fushë, i cili është shpallur punonjës i vitit për tre vjet rresht, kur kualifikimi nuk ishte fare kusht. Mendoj se do të ishte diskriminim nga ana e jonë dhe në përgjithësi, sepse bëhet fjalë për avancim në punë që të kërkohet nostrifikim, i cili aktualisht nuk është i mundur të kryhet jo për fajin e tij, por për disa arsye të justifikuar, për shkak të problemeve politike të pazgjidhura”,* poashtu kolegji i këshillit në lidhje me këtë qështje mori për bazë edhe shkresën/emailin e datës 23.06.2022 nga zyrtarja e Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik e cila në përgjigjen e dërguar Udhëheqëses së Personelit të kësaj komune deklaroi: *“e nderuar, ju njoftojmë se ende nuk ka një marrëveshje aktive që mundëson njohjen e diplomave Kosovë-Serbi, përderisa nuk kemi një marrëveshje finale ndërmjet dy shteteve, ne nuk mund të njohim/nostrifikojmë diploma të cilat janë fituara në Serbi. Ju mundeni të aplikoni për njohje të diplomës konformë UA-12-2018, online në <https://naric-ks.online/por> lënda juaj pezullohet deri në një vendim të caktuar. Në momentin që ka ndonjë progres në këtë drejtim, do të ju njoftojmë”,* poashtu në të njëjtën datë nga e njëjta zyrtare ishte edhe një email/shkresë me përmbajtje të njëjtë poashtu dërguar Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtërpcës, i cili email konfirmon mungesën e progresit në këtë çështje sa i përket nostrifikimit të diplomave të fituara në Serbi. Si rrjedhojë me qenë se nostrifikimi i diplomave është obligim ligjor, fakt i konfirmuar edhe nga palët në procedurë dhe meqenëse në dosje të kandidatit të përzgjedhur nuk ka dëshmi për nostrifikim të diplomës i njëjti nuk do të duhej të përfshihej në listën e shkurtër apo të përzgjidhej nga Komisioni i Pranimit, sepse të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët diplomat i kanë fituar jashtë territorit të Republikës së Kosovës duhet t’i nënshtrohen procedurës së njohjes/barasvlerës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 3 paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ (MASHT)- Nr.12/2018 Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Të gjitha diplomat e shkollave të larta profesionale si dhe ato universitare të fituara jashtë vendit me qëllim punësimi, do t’u nënshtrohen procedurave të njohjes/barasvlerës në MASHT”,* në këtë kuptim kandidati i përzgjedhur është dashur që aplikacionin e tij ta dorëzojë me të dhëna të kompletuara duke i bashkangjitur edhe dokumentacionin e nevojshëm që parashihet në lidhje me këtë procedurë dhe sipas kritereve të

konkursit, sepse dokumentacioni i pa kompletuar refuzohet siç përcaktohet me dispozitat e nenit 15 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë", andaj meqenëse aplikacioni i kandidatit ka qenë i pakompletuar, nga se diploma nuk ka qenë e nostrifikuar rrethanë e konfirmuar nga shkresat e lëndës i njëjti është dashur të refuzohet nga Njësia Përgjegjëse konkretisht Udhëheqësja e Personelit të Komunës së Shtërpcës, kështu që në këtë rast është vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën e punës „Udhëheqës i Sektorit për Kadastër dhe Gjeodezi“ e shpallur më datë 15.08.2023 sipas konkursit me numër reference: RN00012324 nga Komuna e Shtërpcës, është zhvilluar në kundërshtim me nenin 15 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 34 paragrafin 6 nën paragrafin 6.1 dhe paragrafin 7 të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT)- Nr.12/2018 Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nuk i ka shqyrtuar pretendimet e tjera ankimore të ankuesit të parashtruara në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse nuk ishin relevante që mund të rezultojë me vendim ndryshe nga ky si parashihet në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se organi i punësimit Komuna e Shtërpcës, pas pranimit të Vendimit të Këshillit është e obliguar që të ndërmer veprimet administrative me qëllim të zbatimit të obligimeve ligjore që rrjedhin sipas dispozitivit të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e Vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.1281/2023, datë 27/11/2023

Kaltrina Avdullahi-Prënaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet :

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunë së Shtërpcës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Shtërpcës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.